



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News:

Shkodër – Finalizohet megaoperacioni policor i koduar “Fly”
Kurban – Shitnin mallra në mënyrë të paligjshme, në hapësira të zëna pa autorizim në territorin e kishës së “Shna Ndout”, procedohen penalisht 9 shtetas
Policia e Shtetit/Vijon megaoperacioni policor i koduar “Golden Bullet”
Morinë/Goditet një tjetër rast i mosdeklarimit të shumave të konsiderueshme të parave, në pikën e kalimit kufitar.
Policia Rrugore e Elbasanit ndjek denoncimet e qytetarëve, për shkeljet e rregullave të qarkullimit



LajmetOperacionet

06/09/2023

Levan, Fier/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Sinjali”

Levan, Fier/Finalizohet operacioni policor i koduar “Sinjali”. Sekuestrohen 3 armë zjarri pistoleta, 1 armë gjahu dhe fishekë luftarak.

Operacioni, rezultat i administrimit të menjëhershëm të informacioneve të siguruara nga intelijenca policore, për një shtetas që kishte fshehur disa armë.

Arrestohet 61-vjeçari që i kishte futur armët në një çantë, të cilën e kishte fshehur në oborrin e banesës së tij.

Në vijim të punës së pandërprerë në terren, për identifikimin, kapjen dhe arrestimin e shtetasve që posedojnë armë, pa leje, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Fier kanë siguruar informacion për një shtetas që fshihte armë zjarri dhe armë gjahu, në banesën e tij, në lagjen “1 Maji”, Levan. Në bazë të këtyre informacioneve, u finalizua operacioni policor i koduar “Sinjali”, në kuadër të të cilit u ushtruan kontrolle në banesën në pronësi të shtetasit V. M., dhe në territorin përreth saj.

Nga kontrollet, në një çantë të fshehur në oborrin e kësaj banese, shërbimet e Policisë gjetën 3 armë zjarri pistoleta, 1 armë gjahu dhe fishekë luftarak, të cilat posedoheshin pa leje. Armët dhe municioni luftarak u dërguan për ekspertizë, me qëllim verifikimin nëse janë përdorur ose jo, për ngjarje kriminale.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, u arrestua në flagrancë shtetasi V. M., 61 vjeç, banues në lagjen “1 Maji”, Levan, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme.

angazhimpërkushtimsakrificë👮🚓

tëvendosurkundërkrimit✅

nëçdoskajtëvendit🚫

nëshërbimtëqytetarëve👮🤝🧑

denonconë112📞✅

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Dimal, Berat – Si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët, goditet një rast i mbajtjes pa leje të armës së zjarrit

Tiranë – Vihen në pranga 10 shtetas dhe shpallet në kërkim 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale ▶